

**OVERVIEW OF THE FUNCTIONS OF NOMINATIVE CASE IN THE  
ALBANIAN LANGUAGE AND METHOD OF TRANSFERRING  
NOMINAL CONSTRUCTIONS IN THE SERBIAN LANGUAGE  
VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM I FUNKSIONEVE TË RASËS  
EMËRORE PA PARAFJALË NË GJUHËN SHQIPE DHE MËNYRA E  
TRANSFERIMIT TË NDËRTIMEVE NOMINALE NË SERBISHT**

**Marija HRKALOVIC<sup>1</sup>, Naile MALA-IMAMI<sup>2</sup>**

*<sup>1</sup>Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Beograd*

*<sup>2</sup>Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Beograd*

*\*Corresponding author e-mail: marija.hrkalovic@fil.bg.ac.rs, nailje.malja.imami@fil.bg.ac.rs*

---

**Abstract**

The paper discusses nominative case in Albanian language. The most important function that nominative has in Indo-European languages is the function of the subject, and in addition, this case in Serbian and Albanian can perform several other functions that will be presented in this paper. In Albanian the function of the vocative is performed by the nominative without a preposition, which will prove to be the most significant difference between nominative without prepositions in Albanian and nominative in Serbian.

***Key words:** nominative, Albanian, Serbian, case system, subject, nominative without prepositions.*

**Përmbledhje**

Funksioni më i rëndësishëm i emërores në gjuhët indoevropiane është funksioni i kryefjalës, por përveç kësaj, emërorja në gjuhën shqipe ka edhe disa funksione të tjera. Sipas Demirajt (1986: 392, 393), një emër në rasën emërore mund të jetë kryefjalë, kallëzues emëror, përcaktor kallëzuesor i kryefjalës, ndajshim i kryefjalës si edhe pas lidhëzës, përkatësisht pjesëzës *si* dhe mund të jetë edhe thirrur. Në këtë rast (të thirrurit), emërorja ka funksion pragmatik, komunikativ të thirrurit. Po ashtu, mund të ketë funksion të apelativit, të ndajshimit të veçuar, të përcaktorit me përshtatje, të përcaktorit të veçuar (me përshtatje) dhe të fjalisë emërore (apo ekuivalentit të fjalisë). Në këtë punim, përmes shembujve do të paraqesim përdorime të ndryshme të emërores pa parafjalë në gjuhën shqipe, si dhe barasvlerat e përkthimit për të gjithë shembujt në gjuhën serbe. Po ashtu do të përpiqemi të tregojmë se si barten ndërtimet nominale në gjuhën serbe.

***Fjalë kyçe:** rasa emërore, emërorja pa parafjalë, shqipja, serbishtja, funksionet.*

---

## 1. Qëllimi i punimit dhe metodologjia

Qëllimi i këtij punimi është të tregojë funksionet e emërores në gjuhën shqipe dhe të paraqesim se si barten ndërtimet nominale në gjuhën serbe. Krahas shembujve të nxjerrë nga korpusi në punim do t'i theksojmë edhe barasvlerat përkatëse të përkthimit në serbisht. Pas hyrjes dhe vërejtjeve të përgjithshme, do t'i përshkruajmë funksionet e emërores pa parafjalë që kemi arritur t'i gjejmë në disa nga gramatikat e gjuhës shqipe. Përveç kësaj, do të japim sqarime me shembuj se në cilat raste emri përdoret në trajtën e shquar ose të pashquar. Gjithashtu do të japim shembuj të përshtatshëm për çdo funksion dhe kuptim të listuar të emërores së shqipes, duke dhënë barasvlerën përkthimore në gjuhën serbe për çdo shembull nga shqipja. Me këtë rast do të përiqemi të tregojmë se çfarë ndodh me emrat në rasën emërore kur përkthehen në gjuhën serbe.

## 2. Emërorja në gjuhën shqipe

Emrat në rasën emërore në gjuhën shqipe mund të kenë trajtën e shquar dhe të pashquar, me të cilin rast në trajtën e shquar mund të mbarojnë në cilëndo zanore ose bashkëtingëllore, kurse në trajtën e shquar, varësisht nga lakimi të cilit i takon, emri në emërore përfundon në mbaresat *-i*, *-u*, *-a* ose *-ja*, *-it*, *-ët*, *-të* i *-t*, (psh. *lis-i*; *shok-u*; *nën/ë-a*; *lul/e-ja*; *të ftohtë-t*). Ndarja e emrave sipas lakimit bazohet pikërisht në formën e emërores së trajtës së shquar (Agalliu et al., 2002: 112). Në gjuhën shqipe emërorja në radhë të parë e ka rolin gramatikor të kryefjalës. Veçanti e emërores së shqipes, për dallim nga shumica e gjuhëve të tjera indoeuropiane është në faktin se, emri në këtë rasë mund të përdoret edhe me parafjalët, *te /tek* dhe *nga*. Përkthimi i këtyre parafjalëve në serbisht varet nga kuptimi, përkatësisht nga roli sintaksor i parafjalës.

### 2.1. Dallimi morfologjik midis emërores dhe kallëzores

Një nga treguesit e formës rasore në gjuhën shqipe është forma paradigmatiche, përkatësisht mbaresat më parë të përmendura. Megjithatë, morfologjikisht, emërorja dhe kallëzorja dallohen vetëm në trajtën e njëjësit të trajtës së shquar (*shoku / shokun*, *nëna / nënën*, *lisi / lisiin*). Sipas funksionit emërorja dhe kallëzorja dallohen sipas rolit të tyre sintaksor. Kallëzorja në fjali zakonisht shërben si kundrinë e drejtë, kurse emërorja ka disa funksione të ndryshme, me të cilat do të merremi në pjesën e punimit që vijon.

### 2.2. Emërorja si kategori sintaksore

Emri (ose ndonjë fjalë tjetër emërore) në rasën emërore (pa parafjalë) në fjali shërben si **kryefjalë**, si **pjesë e kallëzuesit emëror**, si **përcaktor kallëzuesor**, por edhe si **thirror** (Agalliu et al., 2002: 108; Çeliku, 2012: 25, 157, 158, 216-220, 237-250). Si pjesë e kallëzuesit emëror përdoret bashkë me foljen (këpujën) *jam*, kurse si pjesë e përcaktorit kallëzuesor të kryefjalës, lidhet me një numër të kufizuar të foljeve me kuptim të caktuar leksikor si psh. *tregohem*, *bëhem* etj. (Çeliku et al., 2022: 243). Mund të shërbejë edhe si **ndajshtim**, **ndajshtim i veçuar**, **përcaktor me përshtatje**, **përcaktor i veçuar (me përshtatje)**. Emri (ose ndonjë fjalë tjetër emërore) në rasën emërore mund të shërbejë edhe si **fjali emërore**.

Mund të ketë funksion pragmatik të **apelativit** se në trajtën e pashquar në rasën emërore emri përdoret si formë bazë e fjalëve emërore jashtë funksionit sintaksor. Demiraj (1986: 395) sqaron se në funksionin (pragmatik) të thirrorit zakonisht përdoret trajta e pashquar e emrit, i cili në disa rrethana sintaksore mund të përdoret edhe në trajtë të shquar, pa ndonjë ndryshim kuptimor, sepse në këtë funksion emri kuptimisht është kurdoherë i caktuar. Kur përdoret me parafjalë, emri në rasën emërore largohet nga funksionet e veta themelore sintaksore, dhe i afrohet kuptimit të kallëzores dhe rrjedhore me parafjalë (Agalliu et al., 2002: 108).

### 2.3. Pasqyra e funksioneve të emërores

Të gjithë shembujt të cilët vijojnë janë nxjerrë nga gramatikat e gjuhës shqipe: *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* (Demiraj, 1986), *Gramatika e gjuhës shqipe 1* (Agalliu et al., 2002), *Gramatika e gjuhës shqipe 2* (Çeliku et al., 2002), *Gjuha shqipe, Sintaksa* (Dhima, 2010), *Sintaksa e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, *Vështrim i ri teorik* (Çeliku, 2012), romani *Kronikë në gur* i Ismail Kadare (Kadare, 2000), kurse disa janë shënuar ashtu siç i ka dëgjuar autori në bisedë me shqipfolësit. Këta shembuj i kemi shënuar me shenjën *bised.* Sqarimet e përdorimit të emërores pa parafjalë, para se gjithash i kemi marrë nga *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, (Çeliku et al., 2002), *Gjuha shqipe, Sintaksa* (Dhima, 2010; Çeliku, 2012) dhe *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* (Demiraj, 1986). Për çdo shembull të secilit prej funksioneve të emërores kemi konstatuar cila rasë e serbishtes i përgjigjet emërores në gjuhën shqipe.

#### 1) Emri në emërore në funksion të kryefjalës

Në gjuhën shqipe kryefjala është gjymtyrë kryesore e fjalisë e cila zakonisht shprehet me emrin në emërore pa parafjalë (Çeliku et al., 2002: 167). **Në gjuhën serbe këtij funksioni i përgjigjet po ashtu emërorja kryefjalore (serb. subjekatski nominativ** (Piper et al., 2005: 124)).

A) Emri në trajtën e shquar të emërores pa parafjalë është forma më tipike dhe më e shpeshtë me të cilën shprehet kryefjala në fjali (Çeliku et al., 2002; Dhima, 2010).

(1) **Qielli** ishte i lartë dhe i ftohtë, mbuluar me re ngjyrë hiri, të palëvizshme. [**Nebo** je bilo visoko i hladno, pokriveno sivim, nepokretnim oblacima.] (Kadare, 2000: 20)

(2) **Rrugët** kishin njëfarë gjallërie. [**Ulice** su imale nekakvu živost / su bile nekako živahne.] (Kadare, 2000: 36)

(3) **Dimri** po hidhte mbi qytet shi dhe dhe erë si asnjëherë tjetër. [**Zima** je po gradu bacala kišu i vetar kao nikad do sad.] (Kadare, 2000:231)

3 x ANom = 3 x SNom

#### B) Emrat në trajtën e pashquar në funksion të kryefjalës

Emri është në trajtën e pashquar (4) gjithnjë kur i paraprinë numërori dhe nyja joshquese *një*, si dhe përemri i pacaktuar (dhe nyja joshquese për shumës) *disa* ose përemri dëftor *ky, kjo, këta, këto*. Megjithatë, (5) edhe krahas nyjës joshquese *një / disa*, përkatësisht përemrave të pacaktuar që e nënkuptojnë emrin në trajtën e shquar, emri do të jetë në trajtën e shquar nëse e **shoqëron** përemri pronor. Nga ana tjetër, (6) kur përemri pronor i **paraprin** emrit, emri në emërore do të jetë në trajtën e pashquar. Në trajtën e pashquar (6a, b, c) është edhe emri të cilit i **paraprin** përemri pyetës *cili, cila, cilët, cilat, ç*, përemrat e pacaktuar *çdo, ndonjë, një, ca, disa* dhe etj. (7) Emri do të jetë në trajtën e pashquar kur i paraprin mbiemri. Këto forma konsiderohen togfjalësha emërorë në funksion të kryefjalës.

(4) **Ky fshat** gjendet në Shqipëri. [**Ovo selo** se nalazi u Albaniji.] (*bised.*)

(5) Por: **Një shoku** im u kthye nga udhëtimi. [Jedan moj **prijatelj** se vratio sa putovanja.] (*bised.*)

(6) **Im vëlla** punon në një ndërmarrje private. [**Moj brat** radi u jednom privatnom preduzeću.] (*bised.*)

a. **Cili burrë** do ta kishte atë fat! [**Koji čovek** bi imao tu sreću!] (Çeliku, 2012: 144)

b. **Ç'djall** mund të bredhë në këtë orë? [**Koji đavo** može da luta u ovo doba?] (Çeliku, 2012: 144)

c. **Çdo gjë e gjallë** ka dalë nga uji. [Sve živo (**svaka živa stvar**) je izašla iz vode.] (Çeliku, 2012: 144)

(7) *I shkreti njeri nuk e shijon jetën e tij.* [**Jadan** **čovек** ne uživa u svom životu.] (Çeliku, 2012: 144)

Përveç në rastet e theksuara, emri në trajtën e pashquar në funksion të kryefjalës përdoret edhe në fjalitë kallëzuesi i të cilave është shprehur me folje joveprorë (pësore, vetvetore, mesore) dhe me folje jokalimtare<sup>83</sup> (Çeliku et al., 2002: 168).

(8) *Sekretari kërkoi të mbahej qetësi.* [Sekretar je tražio da se održava **tišina**.] (Çeliku et al., 2002: 168).

Emrat e trajtës së pashquar të cilët e emërojnë klasën e gjërave që janë të numërueshme, e të cilat e kryejnë funksionin e kryefjalës, zakonisht përdoren në formë mohore dhe pyetëse (Çeliku et al., 2002: 168).

(9) *Në pyll as kafshë lëvizte, as shpend fluturonte.* [U šumi niti se **životinja** pomerala, niti je **ptica** letela.] (Çeliku et al., 2002: 168).

Kur emrat janë të panumërueshëm dhe, me këtë rast, janë pjesë e pandashme të llojit të vet (në këtë kuptim emrat nuk kanë shumës), këto fjali si kryefjalë përdoren (në trajtën e pashquar), në formën pohore, mohore, pyetëse dhe dëftore (Çeliku et al., 2002: 168).

(10) *Po bie borë.* [Pada **sneg**.] (*bised.*)

(11) *Fryn erë.* [Duva **vetar**.] (*bised.*)

Emri në shumës në trajtën e pashquar në funksion të kryefjalës përdoret në fjalitë dëftore, pyetëse, pohore ose mohore me folje kallëzues në çfarëdo diateze<sup>84</sup> (Çeliku et al., 2002: 168). Kryefjala në të gjithë shembujt e përmendur është dhënë me emrin në trajtën e pashquar të emërores.

(12) *Kudo thureshin legjenda për të.* [Svuda su se ispredale **legende** o njemu.] (Dhima, 2010:72)

(13) *Re të rënda dhe të ftohta mbulonin majat.* [Teški i hladni **oblaci** su pokrivali vrhove.] (Dhima, 2010: 72)

**13 x ANom = 13 x SNom**

C) Kryefjala në fjali “mund të shprehet haname çdo lloj përemri që përdoret si emër” (Çeliku et al., 2002: 168). Mund të jetë cilido përemër në funksion të kryefjalës (si përemrat vetorë, dëftorë, pyetës, lidhorë ose të pacaktuar) (Çeliku et al., 2002: 168, 169, 170; Dhima, 2010: 72, 73). Të gjithë përemrat në shembujt që vijojnë janë në emërore. Të gjithë shembujt e listuar i kemi marrë nga *Sintaksa e gjuhës shqipe* (Dhima, 2010: 73).

(14) *Ai e vështroi me ëmbëlsi.* [**On** ju je umilno pogledao.]

(15) *Këto ishin udhëtime të bukura.* [**To** su bila lepa putovanja.]

(16) *Kush vjen nga Tirana?* [**Ko** dolazi iz Tirane?]

(17) *Dikush trokiti në derë.* [**Neko** je pokucao na vrata.]

<sup>83</sup> Diatiza joveprorë (serb. *pasivni glagoli*, për dallim nga diatiza veprorë (serb. *aktivni glagoli*): këtu bëjnë pjesë foljet e diatezës vetvetore (serb. *povratni glagoli*) dhe foljet e diatezës pësore (serb. *trpni glagoli*). Në diatezën vetvetore bëjnë pjesë:

1. *Diatiza vetvetore e mirëfilltë* (serb. *pravi povratni glagoli*)

2. *Diatiza vetvetore reciproke* (serb. *uzajamno-povratni glagoli*)

3. *Diatiza mesore* (serb. *nepravi povratni glagoli*)

Diatiza pësore në të cilën hyjnë foljet pësore (serb. *trpni glagoli*), për dallim nga foljet aktive (diatiza veprorë - serb. *aktivni glagoli*) i nënkupton foljet të cilat e tregojnë veprimin të cilin nuk e kryen kryefjala, por e pëson.

<sup>84</sup> Diatiza në gjuhën serbe quhet “glagolski rod”.

- (18) *Secili mund të zgjedhë çfarë të dojë.* [**Svako** može da izabere šta želi.]  
 (19) *Mes kësaj heshtjeje u dëgjua kënga e vajtueshme e hutit që ishte fshehur diku strehëve.* [U sred te tišine čula se tužna pesma sove **koja** se skrila među krovove.]

**6 x ANom = 6 x SNom**

Ç) Çeliku et al. (2002: 170) shpjegojnë që kryefjala në fjali mund të jetë numëror me përdorim emëror. Në shembujt e dhënë (Çeliku et al., 2002: 170) kryefjala është në emërore.

- (20) *Dy mungojnë sot, tre mungonin dje.* [**Dva** nedostaju danas, **tri** su nedostajala juče.]  
 (21) *Të gjashhtë ishin mbledhur e po prisnin.* [**Svih šest** su se skupili i čekali.]  
 (22) *Që të tria ndienin një gëzim të madh.* [**Sve tri** su osećale neku veliku radost.]

**3 x ANom = 3 x SNom**

D) Çeliku et al. (2002: 170) tregojnë për faktin se kryefjalë në fjali mund të shprehet edhe me pjesët e tjera të ligjëratës të emëruara, siç janë mbiemrat e emëruar ose përemrat dëftorë (*i këtillë, i atillë, i tillë*), pastaj përemri i pacaktuar *tjetër* mund të përdoret si kryefjalë edhe në trajtën e shquar edhe të pashquar, si edhe përemrat pronorë të emëruar. Ato pjesë të tjera të ligjëratës përdoren në trajtën e shquar dhe të pashquar, kurse përemrat pronorë të emëruar gjithnjë përdoren në trajtën e shquar. Këto fjalë të emëruara në të gjithë shembujt i kemi marrë nga Çeliku et al. (2002: 170) dhe të gjithë janë përdorur në emërore.

- (23) *E reja nuk çan aq lehtë.* [**Nova** ne cepa tako lako.]  
 (24) *Të vegjlit hidheshin nga gëzimi.* [**Mališani** su skakali od radosti.]  
 (25) *I pari kaloi lirshëm, kurse i fundit ra brenda.* [**Prvi** je prošao slobodno, dok je **poslednji** upao unutra.]  
 (26) *Tjetri ia kishte thënë pothuajse hapur.* [**Drug** mu je rekao takoreći otvoreno.]  
 (27) *Imi është i kuq, yti është i bardhë.* [**Moj** je crveni, **tvoj** je beli.]

**5 x ANom = 5 x SNom**

DH) Kryefjala në fjali sipas Çelikut et al. (2002: 170) mund të shprehet edhe me togfjalësh. Disa togfjalësha të tillë tashmë i kemi përmendur nën B., por do të japim edhe një shembull. Si kryefjalë përdoret edhe togfjalëshi i cili përbëhet nga numërori *një*, nga emra të cilët tregojnë sasi, masë (*tufë, sërë, grumbull...*) (në emërore të trajtës së pashquar) edhe nga emrat në rrjedhore të trajtës së pashquar në shumës (në gjuhën shqipe, por në gjinore në gjuhën serbe), kur folja kallëzues është në shumës. Këtu pjesa e parë e togfjalëshit është (*një* + emri i cili e tregon sasinë) në emërore. Në përkthim në serbisht folja e cila e shpreh kallëzuesin do të jetë në njëjës.

- (28) *Një tufë sorrash zhurmëmëdha fluturonin si të mpira në thellësinë e qiellit.* [**Jato** bučnih svraka letelo je kao obamrlo u dubinu neba.] (Çeliku et al., 2002: 171).

**1 x ANom = 1 x SNom**

## 2) Emri në emërore në funksion të kallëzuesit emëror, përkatësisht si pjesë e kallëzuesit emëror

Sipas Çelikut et al. (2002: 189), kallëzuesi emëror ndërtohet me ndihmën e këpujës dhe gjymtyrës emërore. Pjesa emërore mund të jetë emër, përemër, mbiemër, numëror, togfjalësh dhe paskajore (Çeliku et al., 2002: 190, 194).

A) Gjymtyra emërore e shprehur me emër. Zakonisht është në emërore pa parafjalë, por mund të shprehet edhe me rasat e tjera. Në emërore mund të jetë në trajtën e shquar dhe të pashquar. Në serbisht kjo është emërorja në kallëzuesin këpujor (**serb. *nominativ u kopulativnom predikatu*** (Piper et al., 2005: 125)).

A.1) Forma më tipike e gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror të shprehur me një emër është trajta e pashquar pa ndonjë fjalë përcaktuese (Çeliku et al., 2002: 190).

(29) *Lëvizja është ilac për sëmundjen tënde.* [Kretanje **je lek** za tvoju bolest.] (Çeliku et. al., 2002: 190).

**1 x ANom = 1 x SNom**

A.2) Pjesa emërore e kallëzuesit emëror mund të jetë edhe emri në emërore të trajtës së shquar, nëse është mbiemër i emëruar ose emër i përveçëm (Çeliku et al., 2002: 191).

(30) *Ai shpesh kishte thënë me vete se kryesorja për të ishte puna.* [On je u sebi često govorio da **je** za njega **najbitniji** posao.] (Çeliku et al., 2002: 191).

(31) *Mos je Gëzimi ti?* [Da ti nisi **Gezim**?] (Çeliku et al., 2002: 191).

**2 x ANom = 2 x SNom**

A.3) Emrit në funksion të pjesës emërore të kallëzuesit mund t'i paraprijnë edhe lidhëzat krahasuese *si* ose *sa*. Atëherë emri është në trajtën e pashquar, mundet por edhe jo të përdoret bashkë me një të pashquar *një*, por mund të jetë edhe në trajtën e shquar (Çeliku et al., 2002: 191).

(32) *Lotët e të rinjve janë si shiu i verës.* [Suze mladih su **kao letnja kiša**.] (Çeliku et al., 2002: 191).

(33) *Ata ishin si një turmëz në mes të qytetit tonë.* [Oni su bili **kao** neka **gomilica** usred našeg grada.] (Çeliku et al., 2002: 191).

**2 x ANom = 2 x SNom**

B) Gjymtyra emërore e shprehur me përemër.

B.1) Mund të jetë e shprehur me një përemër vetor, por atëherë përemri vetor ka një përdorim të kufizuar. Paraqitet në fjali që kanë si kryefjalë të njëjtin përemër vetor ose një tjetër dhe tregon identitet (Çeliku et al., 2002: 193).

(34) *Unë s'isha unë.* [Ja nisam bio **ja**. / Ja nisam bila **ja**.] (Çeliku et al., 2002: 193).

**1 x ANom = 1 x SNom**

B.2) Pjesa emërore e shprehur me përemër dëftorë (*ky, kjo, ai, ajo*) është i shoqëruar me ndonjë fjali përcaktore ose ndonjë përcaktor. Pa të përdoret bashkë me pjesëzën *po* (Çeliku et al., 2002: 193).

(35) *Ne ishim ata që i ndërtoam.* [Mi smo bili **ti** koji su ih izgradili.] (Çeliku et al. 2002: 193).

(36) *Asgjë s'kishte ndryshuar; njerëzit ishin po ata, shtëpia po ajo.* [Ništa se nije promenilo; ljudi su bili isti, kuća je bila ista. Bukv. prev: ljudi su **bili ti**, kuća je **bila ta**.] (Çeliku et al., 2002: 193).

**2 x ANom = 2 x SNom**

B.3) Përemrat dëftorë *i tillë, i këtillë, i atillë* tregojnë veçori cilësore (Çeliku et al., 2002: 193).

(37) *Ndoshta ajo natë pranvere nuk ishte e tillë, por ashtu dukej heronjve të mi.* [Možda ta prolečna noć nije bila **takva**, ali je tako izgledala mojim herojima.] (Çeliku et al., 2002: 193).

**1 x ANom = 1 x SNom**

B.4) Përemrat pyetës *kush, cili, cila* përdoren për të identifikuar kryerësin e veprimit (Çeliku et al., 2002: 193).

(38) *Kush jam unë fundi i fundit?* [**Ko sam** ja, na kraju krajeva?] (Çeliku et al., 2002: 193).

**1 x ANom = 1 x SNom**

B.5) Përemrat pronorë tregojnë përkatësi dhe përdoren të emëruar (Çeliku et al., 2002: 193).

(39) *Na dukej sikur tërë bota është jona.* [Çinilo nam se da **je ceo svet naš**.] (Çeliku et al., 2002).

1 x ANom = 1 x SNom

B.6) Si gjymtyrë emërore përdoren edhe përemrat e pacaktuar (Çeliku et al., 2002: 194).

(40) *Çdo gjë do të kryhet në rregull, cilatdo qofshin rrethanat.* [Sve će biti u redu, **koje god bile** okolnosti.] (Çeliku et al., 2002: 194).

1 x ANom = 1 x SNom

B.7) Përemrat, ashtu si edhe emrat, mund të përdoren me lidhëzën krahasuese *si* apo *sa*.

(41) *Pastaj, kush është si ai?* [Onda, ko **je kao on**?] (Çeliku et al., 2002: 194).

1 x ANom = 1 x SNom

C) Gjymtyra emërore e shprehur me numëror. Përdoret rrallë.

(42) *Ora ishte dy pas mesit të natës.* [**Bilo je dva** sata posle ponoći.] (Çeliku et al., 2002: 194).

1 x ANom = 1 x SNom

Ç) Gjymtyra emërore e shprehur me togfjalësh (emëror): me emër në trajtën e shquar të shoqëruar nga një mbiemër, përemër pronor ose nga ndonjë emër në gjinore (Çeliku et al., 2002: 195):

(43) *Agimi është djali yt?* [Agim **je tvoj sin**?] (Çeliku et al., 2002: 195).

1 x ANom = 1 x SNom

D) Gjymtyra emërore e shprehur me mbiemër: këtu mbiemri tregon një karakteristikë cilësore të kryefjalës.

(44) *Liçeni si më parë, ishte i qeshur.* [Jezero je kao i do tada bilo **nasmejano**.] (Çeliku et al., 2002: 194).

1 x ANom = 1 x SNom

### 3) Emri në emërore në funksion të përcaktorit kallëzuesor i shprehur me emër

Çeliku et al., (2002) shpjegojnë se kjo gjymtyrë lidhet me një numër të kufizuar të foljeve me kuptim të caktuar leksikor. Përcaktori kallëzuesor, kur shprehet me emër (ose me togfjalësh emëror) në emërore, lidhet me foljet vetvetore dhe pësore, si edhe me foljet jokalimtare dhe i referohet kryefjalës (2002: 243). Këtij funksioni i përgjigjet **emërorja në kallëzuesin semikopulativ (gjysmëkëpujor) në gjuhën serbe (serb. *nominativ u semikopulativnom predikatu*** (Piper et al., 2005: 126)) .

(45) *Skëndërbeu mund të fitojë çdo betejë, por nuk tregohet po aq mjeshtër [...] [Skenderbeg je mogao da pobedi u svakoj bici, ali se nije **pokazao** (kao) toliki **majstor** [...]] (Çeliku et al., 2002: 243)*

(46) *Ky manifestim u bë vatra e vëllazërimit të popujve.* [Ova manifestacija je **postala ognjište** bratstva naroda.] (Çeliku et al., 2002: 248)

2 x ANom = 2 x SNom

#### 4) Emërorja në rolin pragmatik të thirrorit

Demiraj (1986: 395-396) ka shpjeguar se në funksion (pragmatik) thirrori zakonisht e përdor emrin në trajtë të pashquar, por në disa rrethana mund të përdoret edhe në trajtë të pashquar duke mos e ndryshuar kuptimin. Në këtë funksion emri zakonisht përdoret me “kuptim të individualizuar” (47) (Demiraj, 1986: 395-396), por mund të përdoret edhe me kuptim të përgjithësuar (48). Thirrori në gjuhën shqipe në aspektin gramatikor nuk është i lidhur me gjymtyrët e fjalisë, por e shënon qenien ose sendin të cilit i drejtohet ligjërimi (Çeliku, 2012: 235).

Sipas tij, thirrortë përdoren në dialog, në letërsinë artistike, ligjërimi oratorike, në fjalime, parulla, njoftime, kushtrime, urdhëresa, shpallje etj. për t'i tërhequr vëmendjen vetës a vetave kujt i drejtohet folësi. Çeliku (2012: 238) shpjegon se si emri në rolin e thirrorit përdoret në emërore, në trajtë të pashquar, kurse Demiraj (1986: 395) flet edhe për përdorimin e emrit në trajtë të shquar në rolin e thirrorit nën disa kushte sintaksore pa ndryshimin e kuptimit, sepse në këtë funksion emri kuptimisht është gjithnjë i caktuar. Në fjalitë e mëposhtme emrat janë përdorur në formën morfologjike të emërores.

(47) *Mos më qaj, moj yll, moj dritë...* [Nemoj mi plakati, o zvezdo, o svetlosti...] (KPL, 1

(48) *Njeri! Puno, mos psho kurrë [...]. [Čoveče! Radi, nikad ne odmaraj [...]]* (Naimi, Bagëti e Bujqësia) (Demiraj, 1986: 396)

2 x ANom = 2 x SVok

#### 5) Fjali emërore (ose emërorja në funksionin e ekuivalentit të fjalisë)

Çeliku et al. (2002: 392) i shpjegojnë fjalitë njëkryegjymtyrëshe në të cilat kjo gjymtyrë shprehet me emër dhe fjalitë e këtilla emërtojnë “fjali emërore”. Këto janë fjali të cilat e pohojnë praninë, qenien e sendit ose të fenomenit të emëruar me gjymtyrën kryesore të fjalisë. Sipas Çeliku et al. (2002: 392) kjo gjymtyrë mund të shprehet me një emër në emërore ose me një emër të shquar në emërore të prirë nga pjesëza *ja* (serb. *evo*). Përdorimi i emrit në emërore nga shembulli (48) në gjuhën shqipe përputhet me të njëjtin përdorim të emërores në gjuhën serbe. Këtij përdorimi në gjuhën serbe i përgjigjet **emërorja në funksionin e ekuivalentit të fjalisë** (serb. *nominativ u funkciji rečeničnog ekvivalenta* (Piper et al., 2005: 125).

Por kur bëhet fjalë për shembullin (50) në të cilin me pjesëzën *ja* (serb. *evo*) përdoret trajta e shquar e emrit në rasën emërore, në gjuhën serbe kemi një situatë tjetër: Piper et al. (2005: 130) tregojnë “**modelin e gjinore së lirë me prezentativë**” apo “**eksklamativë**” (serb. *model slobodnog genitiva uz prezentative* ose *eksklamative*). Këtu, “prezentativët” janë fjalët të cilat, në komunikim të drejtpërdrejtë, shërbejnë për të tërhequr vëmendje në ndonjë send, kurse “eksklamativët” nënkuptojnë pashirrim në serbisht *evo, eto, eno, gle* etj. (shq. *ja...*) në ekuivalentë të fjalisë, si për shembull: serb. *Evo autobusa!* [shq. Ja autobusi!] me kuptimin *Po vjen autobusi!* [serb. *Evo stiže autobus!*]. Në raste të tilla - në përdorimin e eksklamativit me një emër në gjuhën serbe, emri është në rasën gjinore.<sup>85</sup>

(49) *Natë!* (= *Është natë.*) [Noć! (= Noć je.)] (Agalliu et al., 2002: 392)

(50) *[...]Ja shatërvani, ja edhe stoli. [...]Evo fontane, evo i hoklice.]* (Çeliku et al., 2002: 392)

2x ANom = 1 x SNom + 1 x SGen

<sup>85</sup> Mendojmë se është interesant të përmendet një lloj i përdorimit dialektor të emërores në vend të gjinore me pjesëza demonstrative të cilat në të folmet e Pomoravles së Paraqinit të Serbisë i ka vërejtur Sofija Miloradoviç (Sofija Miloradoviç): serb. *ono narod! pa momci, pa devojke, pa pesma, pa igranke.* (shq. *ja populli! e djemtë, e vajzat, e kënga, e kërcimet.*) (Miloradoviç, 2003: 46). Në bazë të kësaj, edhe disa studime sintaksore të tjera, Boshnjakoviç (Bošnjaković, 2021) flet për karakteristikat e emërores në disa të folme popullore.



## 6) Emërorja apelative

Emri në trajtën e pashquar në emërore përdoret si formë bazë e fjalëve emërore jashtë funksionit sintaksor (Piper et al., 2005: 124). Ai është „bazë referente e emrit që jepet si fjalë përfaqësuese në fjalorë, leksikonë, regjistra e të ngjashme.“ (Malja-Imami, 2016: 71). Këtij funksioni të emërores së shqipes i përgjigjet **emërorja apelative** e serbishtes.

(51) “**LIS** m. 1. bot. Dru pylli i lartë, me gjethe me dhëmbëza anash, që lidh lëndë dhe që përdoret si lëndë ndërtimi e për zjarr; dushk. Lis i bardhë qarri [...]”<sup>86</sup> - rečničko objašnjenje imenice *lis* (srp. hrast).

**1 x ANom = 1 x SNom**

Piper et al. (2005: 124) shpjegojnë se emërorja jo veç që përdoret në funksionin e kryefjalës gramatikore, por mund ta ketë edhe funksionin e shtesës së kryefjalës. Këto janë: atribut/përcaktor me përshtatje; atributiv/ndajsthim; apozicion/ndajsthim i veçuar; apozitiv/përcaktor i veçuar (serb. *atribut, atributiv, apozicija* dhe *apozitiv* (Piper et al., 2005: 124)). Shembujt në vijim në gjuhën serbe i kemi marrë nga Piper et al. (2005: 124) dhe i kemi përkthyer në shqip dhe po ashtu i kemi dhënë edhe disa shembuj, të cilët i kemi marrë nga Çeliku et al. (2002) dhe i kemi përkthyer në serbisht.

## 7) Atribut (serb. *atribut*, (Piper et al., 2005: 124 )) - Përcaktori me përshtatje

Këtij funksioni i përgjigjet funksioni i **përcaktorit me përshtatje** në gjuhën shqipe. Atributi në gjuhën serbe, sipas Piperit et al. (2005: 66) e përcakton emrin dhe përshtatet me të me forma të tij gramatikore. Ashtu si përcaktori me përshtatje në gjuhën shqipe, i cili shprehet me mbiemër, përemër apo numëror (Çeliku et al., 2002: 223), edhe atributi zakonisht është shprehur me mbiemër, apo fjalë mbiemërore (serb. *takav, prvi... / shq. i tillë, i parë...*), me fjalë të tjera: atributi tipik është *atributi mbiemëror i ndryshueshëm* (serb. *promenljivi pridevski atribut*, Piper et al., 2005: 66).

(52) **Libri i mirë** lexohet me dëshirë. [**Dobra knjiga** se uvek rado čita.] (Piper et al., 2005: 124).

**1 x ANom = 1 x SNom**

## 8) Atributiv (serb. *atributiv* (Piper et al., 2005: 124 )) - Ndajsthim

Funksionit të atributivit nga serbishtja i përgjigjet funksioni i **ndajstimit** në gjuhën shqipe, ashtu siç është paraqitur te Çeliku et al. (2002: 237-239). Një dallim morfologjik midis atributivit të serbishtes dhe ndajstimit të shqipes është fakti se atributivi i serbishtes **zakonisht përshtatet me emrin në rasë, numrin dhe gjininë** (53) (Piper et al., 2005: 69). Nga ana tjetër, ndajstimi i shqipes, sipas Çelikut et al. (2002: 237) shprehet me emër të pashquar në rasën emërore dhe përshtatet vetëm në numër me emrin të cilin e shpjegon (54) (p.sh: *popull mik, popullit mik, popullin mik, popuj miq*, etj.). (Çeliku et al., 2002: 237). Në disa raste atributivi (apo *atributi emëror* (serb. *imenički atribut*), sipas Piperit et al. (2005: 69)) në gjuhën serbe mund të jetë i pandryshueshëm (55) (p.sh: serb. *tetka Olga, tetka Olge* - shq. *tezja Olga, teze Ollgës*) (Piper et al., 2005: 69).

(53) serb. *Ptice selice idu na jug*. [shq. Zogjtë **shtegtarë** shkojnë në jug.] (Piper et al., 2005: 124).

(54) *Dhe kështu vazhdonte jeta e atyre grave **makina**, pa pasion, pa ndjenja, pa logjikë, pa dhembje, pa miq*. [I tako je tekao život tih žena **mašina**, bez strasti, bez osećaja, bez logike, bez boli, bez prijatelja.] (Çeliku et al., 2002: 23)

(55) serb. *Daj to **tetka** Mari*. [shq. Jepja **teze** Marës.] (*bised.*)

**3 x ANom = 2 x SNom + 1 x SGen**

<sup>86</sup> Shpjegimi për emrin *lis* është marrë nga Fjalori i gjuhës shqipe i Akademisë së Shkencave dhe Arteve: <http://www.fjalori.shkenca.org/>

### 9) Apozicion (serb. *apozicija* (Piper et al., 2005: 124 )) - Ndajshtimi i veçuar

Apozicioni, në një kuptim më të gjerë, është përcaktori i emrit, i spikatur ose i ndarë me intonacion apo me shenja pikësimi nga emri apo fjala apo shprehja që e përcakton, dhe përshtatet në rasë me të (Piper et al., 2005: 71). Përndryshe nga atributi dhe atributivi, apozicioni është përcaktori i jashtëm, ai i referohet tërë shprehjes të cilën e përcakton, jo vetëm gjymtyrës së saj kryesore (Piper et al., 2005: 71). Në gjuhën shqipe kemi gjymtyrët e veçuara, njëra prej të cilave i përgjigjet mirë funksionit të apozicionit në serbisht. Sipas Çelikut (2012: 216) ndajshtimet e veçuara japin në mënyrë të spikatur një karakteristikë të një personi a sendi, ose saktësojnë kuptimin e një gjymtyre tjetër. Në shembullin që jep Çeliku (2012: 217) mund të shohim se shprehja e ndarë me intonacion, por edhe me presje, përshtatet në rasë (në këtë rast me rasën kallëzore) me emrin të cilin e përcakton, p.sh: shq. *Përpiqej të gjente midis tyre Yllin, traktoristin e saj.* [serb. *Trudila se da među njima pronađe Ilija, svog traktoristu.*].

Një shembull tjetër, që po ashtu dëshmon për përshtatjen e ndajshimit të veçuar me emrin apo shprehjen që shpjegon në rasë (po ashtu në kallëzoren), japin Çeliku et al. (2002: 332): *Kësaj here ndolli Balashkën, dhinë që i jepte kecat më të shëndoshë dhe qumësht më shumë.* [serb. *Ovog puta je dozvaio Beljašku, kozu koja je davala najzdravije jariće i najviše mleka.*]. Megjithatë, ndajshtimet e veçuara të shprehura me emra mund të vihen edhe në emërore (58) (pavarësisht nga rasa e emrit apo shprehjes e cila shpjegohet), kurse në gjuhën serbe apozicioni mbetet në po të njëjtën rasë si emri apo shprehja e shpjeguar. Pra, funksionit të apozicionit në gjuhën serbe i përgjigjet **funksioni i ndajshimit të veçuar në gjuhën shqipe.**

(56) serb. *Beograd, glavni grad, leži na ušću Save u Dunav.* [shq. Beogradi, **krueqytet**, shtrihet në ngushticën e Savës në Danub.] (Piper et al., 2005: 124).

(57) *Më këmbë mbeti Drita, sekretarja e drejtorit.* [Na nogama je ostala Drita, **sekretarica direktora.**] (Çeliku, 2012: 216)

(58) *Më 2 shkurt korrieri u nis në drejtim të Labinotit, katund i Elbasanit.* [Drugog februara kurir je krenuo u pravcu Labinota, **sela Elbasana.**] (Çeliku, 2012: 217)

**3 x ANom = 2 x SNom + 1 x SGen**

### 10) Apozitivi (serb. *apozitiv* (Piper et al., 2005: 124 )) - Përcaktori i veçuar (me përshtatje)

Apozitivit, apo apozicionit mbiemëror (serb. *pridevska apozicija*, (Piper et al., 2005: 72)) nga serbishtja i përgjigjet funksioni i **përcaktorit të veçuar (me përshtatje)** në gjuhën shqipe, ashtu siç është shpjeguar në Çeliku et al. (2002: 330, 331) dhe Çeliku (2012: 211-215). Në gjuhën serbe apozitivi, përndryshe nga apozicioni (serb. *apozicija*) apo apozicioni i vërtet, d.m.th., apozicioni emëror, nuk ka status të shprehjes emërore. Si në gjuhën shqipe ndahet me intonacion apo shenja pikësimi nga mjedisi i tij sintaksor.

(59) *Pera, umoran, seo je da se odmori.* [Pera, **i lodhur**, u ul të pushojë.] (Piper et al., 2005: 124).

(60) *Qentë e lagjes, të alarmuar, bënë një potere të madhe.* [Psi iz naselja, **uznemireni**, dali su se u veliku graju.] (Çeliku et al., 2002: 330, 331)

**2 x ANom = 2 x SNom**

## Përfundime

Në punim përafërsisht është paraqitur sistemi rasor në gjuhën shqipe, dhe veçanërisht jemi marrë me emëroren dhe përdorimin e saj. Duke marrë parasysh se në mënyrë parësore kësaj rase i takon roli i kryefjalës në gramatikë, në të dy gjuhët emërorja është rasë qendrore, e pavarur. Emëroja në gjuhën serbe realizohet vetëm si formë e lirë rasore meqenëse përdoret pa përcaktorë të obligueshëm dhe pa parafjalë (Piper et al., 2005: 121). Në gjuhën shqipe emëroja pa parafjalë është formë e lirë rasore, por realizohet si formë e varur rasore kur përdoret me parafjalët (*nga* dhe *te(k)*).

Funksionet e emërores së shqipes pa parafjalë përputhen mjaft me funksionet e emërores që i ka gjuha serbe: emërorja zakonisht e ka funksionin e kryefjalës (1), e pastaj edhe të pjesës emërore të kallëzuesit, d.m.th., mund të jetë pjesa emërore e kallëzuesit këpujor (2). Po ashtu mund të ketë funksion të përcaktorit kallëzuesor, d.m.th., mund të jetë pjesa emërore e kallëzuesit gjysmëkëpujor (3). Mund të ketë funksionin e apelativit (6), të atributit (7), të atributivit (8) të apozicionit (9) dhe të apozitivit (10). Mund ta ketë funksionin e ekuivalentit të fjalisë, d.m.th., mund të jetë fjali emërore (5). Gjithashtu kemi pohuar se emërorja pa parafjalë e gjuhës shqipe në trajtën e pashquar e ka edhe rolin pragmatik të thirrorit (4).

Duhet përmendur edhe faktin se në serbisht emri në formën morfologjike të thirrorit nuk është parakusht për formimin e shprehjes së thirrorit, por është element konstitutiv i shprehjes së vokativit dhe emri ose ndonjë fjalë tjetër emërore e përdorur në formën morfologjike të emërores (Piper et al., 2005: 650), si psh: serb. *Kelner, da platim [...]* (shq. *Kamerier, ta paguaj [...]*) (Piper et al., 2005: 650). Kemi vërejtur edhe se gjatë përdorimit të emrit në rasën emërore me pjesëzën *ja* (serb. *evo*) në funksion të ekuivalentit të fjalisë në gjuhën shqipe i përgjigjet përdorimi i gjinore në të njëjtin funksion në gjuhën serbe. Në korpusin prej 60 fjalive në gjuhën shqipe, vumë re se në 55 fjali emërorja në gjuhën shqipe ka dalë po ashtu në emëroren e serbishtes, kurse në tri fjali në gjinoren e serbishtes dhe dy fjali në thirrur. Pra, përdorimi i emërores në shqip dhe në serbisht në këtë punim u përputh në 91,66% të rasteve.

## Shkurtesat:

ANom – emërorja e gjuhës shqipe

SNom – emërorja e gjuhës serbe

SVok – thirrori i gjuhës serbe

SGen – gjinorja e gjuhës serbe

serb. – serbisht

shq. – shqip

## Referenca:

- [1.] Agalliu, F. Angoni, E. Demiraj, Sh. Dhrimo, A. Hysa, E. Lafe, E. Likaj, E. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 1*. Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë. Tiranë.
- [2.] Buxheli, L. (2009). *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*. Botimet Neraida. Tiranë, 2009.
- [3.] Çeliku, M. (2012). Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë). Vështrim i ri teorik. Ilar: Tiranë.
- [4.] Çeliku, M. Domi, M. Floqi, Sh. Mansaku, S. Përnaska, R. Prifti, S. Totoni, M. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2*. Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë. Tiranë.
- [5.] Demiraj, Sh. (1986). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Enver Hoxha, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. 8 Nëntorit. Tiranë.
- [6.] Dhima, Th. (2010). *Gjuha shqipe. Sintaksa*. Universiteti Eqrem Çabej. Gjirokastrë.
- [7.] Malja-Imami, N. (2016). *Gramatika albanskog jezika. Fonetika i morfologija*. NNK International. Beograd.
- [8.] Malja-Imami, R. N. (2012). *Konvergencija i divergencija padežnih sistema u balkanskom jezičkom arealu*. Doktorska disertacija. Univerzitet u Beogradu, Filološki fakultet <https://fedorabg.bg.ac.rs/fedora/get/o:7073/bdef:Content/get>
- [9.] Topalli, K. (2009). *Nyjat e shqipes*. Botimet Toena. Tiranë.
- [10.] Topalli, K. (2009). *Sistemi rasor i emrave të shqipes*. Plejad. Tiranë.
- [11.] Bošnjaković, Ž. (2021). *Funkcije i značenja nominativa u govoru sela Binač i Klokot u Gornjoj Moravi*. Zbornik Matice srpske za filologiju i lingvistiku. Vol. 64 (2021) No. 1. Article 4. Matica srpska. Odeljenje za književnost i jezik. Novi Sad. (str. 67–95). (ISSN 0352-5724)

[12.] Miloradović, S. (2003). Upotreba padežnih oblika u govoru Paraćinskog Pomoravlja: balkanistički i etnomigracioni aspekt. Etnografski institut SANU. Beograd. [https://hdl.handle.net/21.15107/rcub\\_dais\\_1011](https://hdl.handle.net/21.15107/rcub_dais_1011)

[13.] Piper, P., Antonić, I., Ružić, V., Tanasić, S., Popović, Lj., Tošović, B. (2005). Prilozi gramatici srpskog jezika. Sintaksa savremenoga srpskog jezika. Prosta rečenica. urednik: Milka Ivić. Institut za srpski jezik SANU. Beogradska knjiga. Matica srpska. Beograd.

**Fjalorët:**

Kostallari, A., Thomaj, J., Lloshi, Xh., Samara, M., Kole, J., Daka, P., Haxhillazi, P., Shehu, H., Leka, F., Lafe, E., Sima, K., Feka, Th., Keta, B., Hidi, A. (1980). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë. Tiranë.

**Burimet:**

Kadare, I. (2000). *Kronikë në gur*. Onufri. Tiranë

**Burimet nga interneti:**

Fjalor i gjuhës së sotme shqipe: <http://www.fjalori.shkenca.org/>